



NEON A.S
RR.XHANFISE KEKO, Nd.168 , H.1, CP. 1005
TIRANA, ALBANIA
TEL: +355 42 377 773 FAX: +355 42 347 770
E-MAIL: info@neon.al WEB: www.neon.al

NEON REMOVER PROFFESIONAL (GERRYES BOJE) Skedë Teknike

PËRSHKRIMI: NEON REMOVER PROFFESIONAL është një produkt special i formuluar nga përzierja e disa lloje solventësh të padjegshëm. Ai mund të zbutë, të tresë dhe të gërryjë shtresat e vjetra të bojës. Ai gjithashtu mund të heqë bojrato alkide, bojrato e kaldajave dhe në mënyrë shumë efektive të bojrave ujore. Ai gjithashtu mund të gërryjë poliuretanët dy komponentë, rreshirat dhe gjithë llojet e tjera të bojrave. Ai ka veti të mira penetrimi dhe nuk e dëmton sipërfaqen ku do të aplikohet.

FUSHA E PËRDORIMIT: NEON REMOVER PROFFESIONAL përdoret për gërryerjen e shumë bojrave të forta dhe të vjetra si ato alkidet, të kaldajave, makinerive, rrëshirave, dhe ato ujore. Mund të aplikohet mbi metal, çimento, plastikë, qelq. Rekomandohet të përdoret pa u holluar.

NGJYRA: e verdhë në kafe.

PARAPËRGATITJA: Përpara se të aplikohet kontrolloni sipërfaqen nëse është nga ato sipërfaqe që rekomandohet përdorimi i REMOVER-it..

PËRDORIMI: Përdoret pa u holluar, lyhet sipërfaqja me furçe ose rrul nga e cila duam të heqim bojën, lihet për zbutje për rreth 20 minuta dhe pastaj me anën e një spatule lehtësisht heqim mbetjet e bojës mbi sipërfaqe. Nëse sipërfaqja që duam të pastrojmë është e lyer me disa shtresa boje, mund të aplikojmë një dorë të dytë.

KUJDES: Nuk lejohet aplikimi i bojës në sipërfaqe të njoma dhe të pa pastruara paraprakisht. Gjatë aplikimit të përdoren doreza të përshtatshme pune për të evituar kontaktin e bojës me lëkurën, si dhe në rastin e përdorimit të pistoletës duhet përdorur maskë mbrojtëse për organet e frymëmarrjes. Në rast kontakti me sytë, duhet bërë shpërlarja e tyre me ujë të bollshëm dhe të kërkohet ndihmë mjeksore. Nuk rekomandohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 5°C. Pas përfundimit të lyerjes paisjet duhet të lahen menjëherë me white spirit.

TE DHENAT TEKNIKE:

- Ngjyra.....e verdhë në kafe
- Koha e tharjes.....15 – 25 min

REZIKSHMËRIA: NEON REMOVER janë të djekshme (R10), të dëmshme po të nuhaten (R20), irritojnë lëkurën (R38) si dhe duhet të ruhen larg fëmijëve (S 2), në vënde të ajrosura mirë (S 9) dhe larg burimeve të zjarrit (S 16). Po kështu,

mbeturinat e bojës nuk duhen derdhur në kanalet e shkarkimit (S 29) dhe ambalazhet e përdorura duhen hedhur në vende të sigurta (S 35).

AMBALAZHIMI: Ambalazhimi bëhet në kuti metalike 0.75L.